

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Joint Stock Companies
Trepça Deoničarsko Društvo

Nr. 876 Data 23.02.2022
Mitrovicë Mitrovicë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



RREGULLORE PËR REPREZENTACION NË TREPÇA SH.A

Mitrovicë, më 16.02.2022

Në bazë të nenit 95 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 3 paragrafi 1.4 i Ligjit Nr.05/L-120 për Trepçën, Ligjit NR. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 20 të Ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 130 të Ligjit nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare dhe nenit 8 të Statutit të Trepça Sh.A, Bordi i Mbikëqyrës i Trepça Sh.A., në mbledhjen e mbajtur më 16.02.2022, miraton këtë:

Rregullore për reprezentacion në Trepça Sh.A

Neni 1 Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e shumës maksimale të reprezentacionit në Ndërmarrjen Trepça Sh.A, si dhe procedurën e përdorimit të rregullt gjatë kryerjes së punëve dhe ushtrimit të përgjegjësisve nga të punësuarit e ndërmarrjes.

Neni 2 Reprezentacioni

1. Të drejtën në reprezentacion e kanë:
 - 1.1. Kryeshefi Ekzekutiv
 - 1.2. Zëvendës Kryeshefi Ekzekutiv
 - 1.3. Sekretari Korporativ,
 - 1.4. Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit, dhe
 - 1.5. Zyrtari i Auditimit të Brendshëm.
2. Me vendim të veçantë ë Bordit Mbikëqyrës të Trepça Sh.A mund të përcaktohen kufizime në vlera lidhur me të drejtën e shfrytëzimit të reprezentacionit.

Neni 3

Vlera e shpenzimeve të reprezentacionit

1. Në emër të reprezentacionit nga bufeja e ndërmarrjes, Kryeshefi Ekzekutiv, zëvendës Kryeshefi Ekzekutiv, Zyrtari Kryesor Financiar, Sekretari Korporativ dhe Zyrtari i Auditimit të Brendshëm i Trepça Sh.A, kanë të drejtë të shpenzimit deri në 100€ në muaj.

2. Në emër të reprezentacionit jashtë ndërrmarjes, Kryeshefi Ekzekutiv i ndërrmarjes ka të drejtën e shpenzimit për dreka zyrtare deri në 800 euro në muaj, ndërsa Sekretari Korporativ, Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit dhe Zyrtari i Auditimit të Brendshëm kanë të drejtën e shpenzimit për dreka zyrtare deri në 100 euro në muaj.

Neni 4

Përdorimi i shpenzimeve të reprezentacionit

1. Shpenzimet e reprezentacionit nuk mund të përdoren për qëllime tjera, përveç atyre që janë të përcaktuara në këtë rregullore.
2. Të gjitha shpenzimet e reprezentacionit duhet të arsyetohen me fatura përkatëse të nënshkruara nga shpenzuesi i autorizuar sipas kësaj rregullorje.
3. Faturat përkatëse të cilat nuk janë të nënshkruara nga shpenzuesi i autorizuar sipas kësaj rregullorje nuk do të pranohen dhe mbulohen nga vetë zyrtari (shfrytëzuesi) në mënyrë individuale.

Neni 5

Dispozitat përfundimtare

Kjo Rregullore për reprezentacion në Trepça Sh.A, hynë në fuqi në ditën e aprovimit dhe fillon të aplikohet prej ditës së publikimit në webfaqen zyrtare.

Kryesuesi i Bordit Mbikëqyrës të Trepça Sh.A



Dr.Sc. Bahri Hyseni

